Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0782

Paneli Shqyrtues, i caktuar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Isa Hasani panelist individual duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik"Vizion Project" N.N.SH & GeoEng L.L.C. kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit të Komuna Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: "184 – Studimi I fizibilitetit per furnizim me uje permes puseve dhe rezervuareve ne fshatrat e Gollakut"me numër të prokurimit:**616-26-5518-5-2-1**, me 06/11/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.N.SH. "Vizion Project ", me nr. 2026/0782,e datës, 09.10.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "184 – Studimi i fizibilitetit per furnizim me ujë përmes puseve dhe rezervuareve në fshatrat e Gollakut" me numër të prokurimit:616-26-5518-5-2-1, ndërsa Mbetet në fuqi, vendimi autoritetit kontraktues,Komuna Prishtinës.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues N.N.SH. "Vizion Project, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 08.07.2026 Komuna Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "184 – Studimi I fizibilitetit per furnizim me uje permes puseve dhe rezervuareve ne fshatrat e Gollakut" me numër të prokurimit:**616-26-5518-5-2-1**.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 200,000.00 €.

Me28.09.2026 GOE "Vizion Project" N.N.SH & GeoEng L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK.

OSHP ka pranuar ankesën nga GOE "Vizion Project" N.N.SH & GeoEng L.L.C. me nr. 0782/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit "184 – Studimi I fizibilitetit per furnizim me uje permes puseve dhe rezervuareve ne fshatrat e Gollakut" me numër të prokurimit**:616-26-5518-5-2-1.**

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Pretendimet e grupit te operatorit ekonomik ankues "Vizion Project" N.N.SH & GeoEng L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1 - 8.1 Interesi juridik dhe shterimi i procedurës paraprake

Në pretendimin ankimor 1 OE ka shprehur interesin juridik dhe deklarimin e udhëheqjes së procedurës paraprake, ku ka deklaruar se është palë e interesuar sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, pasi ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe eliminimi e ka privuar nga mundësia për lidhjen e kontratës. OE ka theksuar se oferta e tij është 177,750.00 € ndërsa e grupit të rekomanduar është 184,530.00 € që është 6.780,00 € më e lirë se oferta e grupit të rekomanduar për kontratë, duke deklaruar se kjo diferencë e bënë të drejtpërdrejtë interesin e OE ankues për korrigjimin e vlerësimit.

Gjithashtu, OE ka deklaruar se e ka përmbushur procedurën paraprake përmes kërkesës së datës 28.09.2026, ndërsa AK-ja, me vendimin e datës 30.09.2026, ka konstatuar se kërkesa ishte e lejuar dhe se nuk kishte pengesa për shqyrtimin e saj në aspektin meritor.

Në fund, OE ka theksuar se ankesa është paraqitur më 09.10.2026, brenda afatit dhjetëditor të përcaktuar me nenin 109.1 të LPP-së, dhe se data dhe ora e dorëzimit dëshmohen përmes konfirmimit të platformës elektronike.

Pretendimi ankimor 2 - 8.2 Eliminimi ynë dhe licenca profesionale e gjeodetit

OE ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht nga aktiviteti i prokurimit, sepse AK-ja nuk ia ka pranuar licencën e gjeodetit Milaim Sylka, të lëshuar nga AKK-ja. Sipas OE-së, licenca ka qenë e vlefshme dhe është dorëzuar para afatit të ofertimit, prandaj nuk bëhet fjalë për mungesë dokumentacioni, por për mënyrën se si AK-ja e ka interpretuar dhe vlerësuar atë.

OE thekson se në FDT-në, pikat 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 7 është formuluar fjalë për fjalë kështu: "1 (një) Inxhinier Gjeodezie, me diplomë universitare ose Master i Shkencës (MSc), me minimum 3 (tre) vite përvojë pune", me dëshmi: "Të dorëzohen CV-ja, licenca A, diploma, referencat e punës dhe kontrata e punës." OE nuk pretendonë se licenca e AKK-së mban emërtimin "Licencë A". OE ankues Pretendon se autorizimi profesional i gjeodetit duhet vlerësuar duke e lidhur kërkesën e publikuar me punët konkrete dhe me regjimin ligjor që i rregullon ato. Në vazhdim OE ka shqyrtuar tekstin e plotë të DT-së dhe konstaton se Termi "licenca A" paraqitet vetëm në kolonën e dëshmive të FDT 9.2, për kërkesat nr. 1, 2, 3, 4 dhe 7. DT-ja sipas OE askund nuk e përcakton organin lëshues të kësaj licence, nuk e përmend OIRK-në apo Ligjin nr. 08/L-012 dhe nuk e definon se çfarë kuptohet me "licencë A". Formulimi është identik për inxhinierët e hidroteknikës, hidrogjeologjisë e ndërtimtarisë dhe për inxhinierin e gjeodezisë, megjithëse licencimi i gjeodetëve për matje kadastrale dhe gjeodezike rregullohet me ligj të posaçëm (Ligji nr. 08/L-237).

Rrjedhimisht sipas OE ankues, kufizimi i kërkesës nr. 7 vetëm në licencën e lëshuar nga OIRK-ja është element që nuk është publikuar në DT. Pas hapjes së ofertave, AK-ja nuk mund ta interpretojë një kërkesë të paqartë në dëm të ofertuesit, duke i shtuar DT-së kushte që nuk janë shpallur (nenet 7, 27 dhe 59 të LPP-së). Në mungesë të përcaktimit të lëshuesit, licenca profesionale e gjeodetit e lëshuar nga autoriteti kompetent sipas ligjit për fushën e gjeodezisë, AKK-ja, duhej pranuar si përmbushje e kërkesës.

Gjithashtu, OE-ja argumenton se AKK-ja ka kompetenca ligjore për licencimin e gjeodetëve për matje kadastrale dhe gjeodezike. Prandaj, licenca e dorëzuar duhet të vlerësohet në bazë të fushëveprimit të saj dhe të detyrave konkrete të parapara në kontratë, si matjet GPS, hartat topografike dhe kadastrale, si dhe identifikimi i parcelave.

Në thelb, OE-ja nuk kërkon ndryshimin e kriterit të tenderit dhe as zëvendësimin e personelit, por kërkon që licenca ekzistuese e AKK-së të shqyrtohet dhe të vlerësohet në raport me kërkesat e dosjes së tenderit dhe legjislacionin përkatës. Për këtë arsye, kërkon nga OSHP-ja pranimin e licencës dhe heqjen e vendimit për eliminim, ose marrjen e sqarimeve nga institucionet kompetente për të përcaktuar nëse për detyrat konkrete të kontratës kërkohet edhe licencë nga OIRK-ja.

Pretendimi ankimor 3 - 8.3 Emërimi i menaxherit për një përbërje tjetër të grupit

OE ankues pretendon se ekziston një mospërputhje në vendimin për emërimin e Agim Lajçit si Menaxher i Kontratës. Sipas tij, në dokumentin e dorëzuar figurojnë ENG IDEA SH.P.K. dhe ARCH EMPIRE L.L.C., ndërsa grupi i rekomanduar për kontratë përbëhet nga ENG IDEA SH.P.K. dhe Lorenco & Co SH.P.K.

OE-ja thekson se ARCH EMPIRE nuk është pjesë e grupit të rekomanduar, ndërsa Lorenco & Co, e cila është anëtare e këtij grupi, nuk figuron në vendimin për emërimin e menaxherit. Për këtë arsye, ai vë në dyshim nëse ekziston dëshmi se Agim Lajçi është emëruar dhe angazhuar rregullisht nga grupi konkret që ka dorëzuar ofertën.

OE kërkon kontrollin e vendimit origjinal, nënshkruesit, marrëveshjes së GOE-së, autorizimeve sipas FDT 11.1 dhe dokumenteve të angazhimit të menaxherit. Nëse këto provojnë objektivisht se emërimi për grupin e saktë ekzistonte më 31.07.2026, OSHP-ja mund të vlerësojë nëse kemi gabim formal të sqarueshëm. OE në këtë rast nuk pretendon se çdo gabim në emërtim sjell automatikisht eliminim. Megjithatë, sipas OE ankues pa këtë provë, një vendim i ri ose zëvendësimi pas afatit i partnerit të shënuar do të rrezikonte krijimin e një angazhimi që nuk është dëshmuar në kohën e kërkuar, në kundërshtim me nenet 59.2 dhe 72.

Nëse angazhimi për grupin ofertues nuk provohet mbi dokumente dhe fakte që ekzistonin para afatit, OE ankues kërkon që pretendimi të aprovohet dhe oferta e rekomanduar të konsiderohet e papërgjegjshme për këtë kërkesë.

Pretendimi ankimor 4 - 8.4 Autorizimi profesional i Almedina Rapucës

OE ankues pretednon se grupi i rekomanduar e ka propozuar Almedina Rapucën me licencë A të OIRK-së nr. N-1218, por nuk ka paraqitur licencë të AKK-së. Sipas OE ankues, disa nga detyrat e përshkruara në Aneksin 1 mund të kërkojnë licencim nga AKK-ja për matje kadastrale ose gjeodezike.

OE ankues nuk ka kundërshtuar vlefshmërinë e licencës së OIRK-së dhe as nuk ka kërkuar që në FDT të shtohet tani një kriter i ri. Ai kërkon që të shqyrtohet nëse detyrat konkrete përfshijnë punë që sipas Ligjit nr. 08/L-237 dhe UA nr. 06/2024 kryhen nga gjeodeti i licencuar prej AKK-së dhe me cfarë autorizimi do të kryhen këto shërbime nga perosneli i propozuar.

Ankuesi gjithashtu pretendon se AK-ja nuk i është përgjigjur plotësisht kësaj çështjeje: vendimi përmend inxhinieren dhe e konsideron kërkesën të përmbushur, por nuk tregon nëse është kontrolluar regjistri i AKK-së dhe nuk shpjegon nëse detyrat e Aneksit 1 kërkojnë licencë të tillë. Sipas OE ankues duhet të verifikohet dhe vlerësohet autorizimi ligjor për punët konkrete dhe se a ka ekzistuar në afatin e ofertimit licenca nga AKK per personin e angazhuar Almedina Rapuca.

Pretendimi ankimor 5 - 8.5 Trajtimi i barabartë në sqarime dhe në vlerësimin e ofertave

OE ankues në këtë pretednim ka kërkuar një trajtim të barabartë ku ka evidentuar se në kërkesën për rishqyrtim ka identifikuar kërkesat për sqarim ndaj grupit të rekomanduar të datave 26.08.2026, 02.09.2026 dhe 15.09.2026. Vetë numri i kërkesave nuk përbën shkelje, sikurse fakti që edhe neve na janë kërkuar sqarime nuk provon vetvetiu se vlerësimi ka qenë i barabartë. Vendimtare është përmbajtja e sqarimeve, provat mbi të cilat janë pranuar dhe nëse ato dëshmojnë gjendjen para afatit.

OE ankues ka kërkuar nga eksperti që të krahasojë përgjigjen e OE ankues të datës 31.08.2026 me sqarimet e grupit të rekomanduar lidhur me pretendimet e mësipërme. OE ka deklaruar se për licencën tonë kërkohet vlerësim i arsyetuar i fushëveprimit; për menaxherin kërkohet lidhja e angazhimit me grupin e saktë; për gjeodeten kërkohet verifikimi i autorizimit të nevojshëm. Për të tria duhet zbatuar standardi i njëjtë i provës dhe i ekzistencës së kapacitetit para afatit.

OE ankues ka theksuar se nëse dokumentet e grupit të rekomanduar pranohen duke plotësuar paqartësi, ndërsa dokumentit tonë ekzistues i mohohet shqyrtimi përmbajtësor, pa dallim objektiv të arsyetuar, cenohen nenet 7 dhe 72 të LPP-së dhe neni 38 i Rregullores.

Qëndrimi i OE ankues është se GOE i tyre i plotëson kërkesat e DT-së. Sipas OE ankues formulari B58 nuk identifikon mangësi tjetër përveç licencës, por kjo nuk e zëvendëson kontrollin e dokumentacionit të ofertës. Pas heqjes së shkakut të eliminimit dhe konfirmimit të përgjegjshmërisë, AK-ja duhet ta përfshijë ofertën tonë në krahasimin sipas kriterit të çmimit më të ulët të nenit 60.1.1 dhe FDT 30.1. Diferenca 184.530,00 € − 177.750,00 € = 6.780,00 € është kursim potencial i fondeve publike, në lidhje me nenet 1 dhe 6 të LPP-së.

OE ankues në këtë pretednim ka dekalaruar se qëndrojnë prapa pjesës së vendimit të AK-së me të cilën ofertuesit e tjerë janë shpallur të papërgjegjshëm dhe nuk kërkojmë ndryshimin e atyre eliminimeve me këtë ankesë, njësoj siç kanë deklaruar edhe në kërkesën për rishqyrtim të datës 28.09.2026.

Pretendimi ankimor 6 - 8.6 Mangësitë e arsyetimit në vendimin e datës 30.09.2026

OE ankues në këtë pretednim e ka cilësuar përgjigjen e AK në vendimin e dt.30.09.2026 si të pamjaftueshme duke mos e lidhur përfundimin me provat dhe argumentet vendimtare të secilës çështje. Sipas OE nakues, AK ka identifikuar tri çështjet kryesore në faqen 2: licencën e gjeodetit, emërimin e menaxherit dhe autorizimin e Almedina Rapucës.

Në faqen 2 të vendimit, nga kërkesa për rishqyrtim janë riprodhuar vetëm paragrafi hyrës dhe titujt e pikave 7.2 dhe 7.3. Asnjë nga argumentet juridike e faktike të kërkesës, si licenca nr. 115 dhe vendndodhja e saj në ofertë, Ligji nr. 08/L-237, UA nr. 06/2024, shkresa e AKK-së dhe detyrat e Aneksit 1, nuk është përmendur apo trajtuar në arsyetim.

OE ankues thekson se: Për ofertën tonë, AK-ja përsërit se mungon Licenca A e kërkuar në DT dhe se dokumenti nuk është paraqitur as në rishqyrtim. Duke deklaruar se në pretendimin e tyre kanë kërkuar vlerësimin e licencës së AKK-së nr. 115 si autorizim për punët konkrete. Vendimi i AK nuk trajton vendndodhjen e saj në ofertë, vlefshmërinë, dispozitat sektoriale, detyrat e Aneksit 1 apo shkresën e AKK-së.

Ndërsa për grupin e rekomanduar, AK-ja shprehet se “i ka faluar besimin të gjeturave të komisionit vlerësues” (vendimi, faqja 2). Sipas OE ankues mbështetja në punën e komisionit nuk e liron autoritetin nga detyrimi për t’iu përgjigjur mospërputhjeve konkrete të ngritura në rishqyrtim. Vendimi nuk shpjegon pse identifikimi i një partneri tjetër në emërimin e menaxherit nuk ndikon në provën e angazhimit, as me cilin dokument ose verifikim është zgjidhur çështja e autorizimit sektorial të gjeodetes.

Po ashtu OE ankues ka dhene bazën ligjore për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësit e AK.

Kërkesa i drejtohet OSHP-së dhe ekspertit shqyrtues të administrojnë dokumentet, t’i analizojnë pretendimet veçmas dhe të japin përfundim meritordhe të japin udhëzimet konkrete të rivlerësimit.

Pretendimi ankimor 7 - 8.7 Administrimi i provave dhe kërkesa për vendim

OE ankues ne kete pike nuk ka ndonjë pretendim të veçantë, por ka kërkuar nga eksperti shqyrtues, në kuadër të neneve 113 dhe 114 të LPP-së, të administrojë dosjen elektronike të plotë të aktivitetit dhe të raportojë veçmas për secilin pretendim.

Në veçanti kërkohen këto verifikime:

1. Të kontrollohen oferta fillestare e GOE-së sonë, faqja 24 e dosjes së gjeodetit, përgjigjja e datës 31.08.2026 dhe vlefshmëria e licencës nr. 115 në afatin e ofertimit.

2. Të krahasohen detyrat e Aneksit 1 dhe kërkesa nr. 7 me fushëveprimin e licencimit nga AKK-ja dhe OIRK-ja; sipas nevojës të kërkohen sqarime zyrtare për bazën konkrete ligjore.

3. Të kontrollohen vendimi i Agim Lajçit, marrëveshja e grupit të rekomanduar, autorizimi i liderit dhe provat që lidhin angazhimin me ENG IDEA & Lorenco & Co para 31.07.2026.

4. Të verifikohet pranë AKK-së gjendja historike e autorizimit të Almedina Rapucës dhe të sqarohet nevoja e këtij autorizimi për detyrat konkrete të propozuara.

5. Të krahasohen sqarimet B47 të të dy grupeve, raporti i vlerësimit, provat e ngarkimit dhe baza mbi të cilën komisioni ka pranuar ose refuzuar dokumentet e kundërshtuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12/10/2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0782/2026, ndërsa me datë 23/10/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0782 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet si pjeserisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

- Lidhur me pretendimet e GOE "Vizion Project" N.N.SH & GeoEng L.L.C. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2026/0782 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS ka udhëhequr aktivitetin e Prokurimit: "184 - Studimi i fizibilitetit për furnizimin me ujë përmes puseve dhe rezervuarëve në fshatrat e Gollakut." me nr. të prokurimit: "633-26-5518-5-2-1".

Me datë 09.07.2026 është publikuar njoftimi për kontratë;

Hapja e ofertave me dt.31.07.2026

Njoftimi mbi vendimin e AK-së dt.21.09.2026

Kërkesa për rishqyrtim pranë AK nga OE 28.09.2026

AK ka nxjerrë vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim me dt.30.09.2026

OE nuk është pajtuar me vendimin dhe ka paraqitur ankesë pranë OSHP me dt. 09.10.2026

Në vazhdim Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar secilin pretendim ankimor të parashtruar nga OE ankues.

Pretendimi ankimor 1 - 8.1 Interesi juridik dhe shterimi i procedurës paraprake

Në pretendimin ankimor 1 OE ka shprehur interesin juridik dhe deklarimin e udhëheqjes së procedurës paraprake, ku ka deklaruar se është palë e interesuar sipas nenit 4.1.26 të LPP-së, pasi ka dorëzuar ofertë në këtë aktivitet të prokurimit dhe eliminimi e ka privuar nga mundësia për lidhjen e kontratës. OE ka theksuar se oferta e tij është 177,750.00 € ndërsa e grupit të rekomanduar është 184,530.00 € që është 6.780,00 € më e lirë se oferta e grupit të rekomanduar për kontratë, duke deklaruar se kjo diferencë e bënë të drejtpërdrejtë interesin e OE ankues për korrigjimin e vlerësimit.

Gjithashtu, OE ka deklaruar se e ka përmbushur procedurën paraprake përmes kërkesës së datës 28.09.2026, ndërsa AK-ja, me vendimin e datës 30.09.2026, ka konstatuar se kërkesa ishte e lejuar dhe se nuk kishte pengesa për shqyrtimin e saj në aspektin meritor.

Në fund, OE ka theksuar se ankesa është paraqitur më 09.10.2026, brenda afatit dhjetëditor të përcaktuar me nenin 109.1 të LPP-së, dhe se data dhe ora e dorëzimit dëshmohen përmes konfirmimit të platformës elektronike.

Përgjigje në pretendimin 1

Eksperti shqyrtues ka analizuar dokumentet e procedurës dhe konsideron se duke u bazuar në dispozitat ligjore OE ankues është palë e interesit sipas nenit 4.1.26 të LPP-së.

Fakti që operatori ekonomik ankues ka paraqitur çmim më të ulët se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk përcakton, në vetvete, rezultatin e ankesës. Megjithatë në asnjë rrethanë nuk mund të mohohet e drejta dhe interesi për ankesë. Në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, oferta financiare mund të merret në konsideratë vetëm pasi të jetë vërtetuar se operatori ekonomik ofertues i përmbush plotësisht të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Vlerësimi financiar bëhet ndërmjet ofertave që janë vlerësuar si të përgjegjshme në pajtim me të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe DT.

Sa i përket afateve ligjore të parashtrimit te ankeses, Eksperti Shqyrtues konsideron se OE ankues brenda afateve ligjore ka zhvilluar procedurën paraprake në pajtim me nenin 108/A të LPP-së, dhe se ankesa është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në dispozitat ligjore neni 109 i LPP-së.

Eksperti shqyrtues ka vlerësuar se pretendimi ankimor 1 është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 2 - 8.2 Eliminimi ynë dhe licenca profesionale e gjeodetit

OE ankues pretendon se është eliminuar padrejtësisht nga aktiviteti i prokurimit, sepse AK-ja nuk ia ka pranuar licencën e gjeodetit Milaim Sylka, të lëshuar nga AKK-ja. Sipas OE-së, licenca ka qenë e vlefshme dhe është dorëzuar para afatit të ofertimit, prandaj nuk bëhet fjalë për mungesë dokumentacioni, por për mënyrën se si AK-ja e ka interpretuar dhe vlerësuar atë.

OE thekson se në FDT-në, pikat 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 7 është formuluar fjalë për fjalë kështu: "1 (një) Inxhinier Gjeodezie, me diplomë universitare ose Master i Shkencës (MSc), me minimum 3 (tre) vite përvojë pune", me dëshmi: "Të dorëzohen CV-ja, licenca A, diploma, referencat e punës dhe kontrata e punës." OE nuk pretendonë se licenca e AKK-së mban emërtimin "Licencë A". OE ankues Pretendon se autorizimi profesional i gjeodetit duhet vlerësuar duke e lidhur kërkesën e publikuar me punët konkrete dhe me regjimin ligjor që i rregullon ato. Në vazhdim OE ka shqyrtuar tekstin e plotë të DT-së dhe konstaton se Termi "licenca A" paraqitet vetëm në kolonën e dëshmive të FDT 9.2, për kërkesat nr. 1, 2, 3, 4 dhe 7. DT-ja sipas OE askund nuk e përcakton organin lëshues të kësaj licence, nuk e përmend OIRK-në apo Ligjin nr. 08/L-012 dhe nuk e definon se çfarë kuptohet me "licencë A". Formulimi është identik për inxhinierët e hidroteknikës, hidrogjeologjisë e ndërtimtarisë dhe për inxhinierin e gjeodezisë, megjithëse licencimi i gjeodetëve për matje kadastrale dhe gjeodezike rregullohet me ligj të posaçëm (Ligji nr. 08/L-237).

Rrjedhimisht sipas OE ankues, kufizimi i kërkesës nr. 7 vetëm në licencën e lëshuar nga OIRK-ja është element që nuk është publikuar në DT. Pas hapjes së ofertave, AK-ja nuk mund ta interpretojë një kërkesë të paqartë në dëm të ofertuesit, duke i shtuar DT-së kushte që nuk janë shpallur (nenet 7, 27 dhe 59 të LPP-së). Në mungesë të përcaktimit të lëshuesit, licenca profesionale e gjeodetit e lëshuar nga autoriteti kompetent sipas ligjit për fushën e gjeodezisë, AKK-ja, duhej pranuar si përmbushje e kërkesës.

Gjithashtu, OE-ja argumenton se AKK-ja ka kompetenca ligjore për licencimin e gjeodetëve për matje kadastrale dhe gjeodezike. Prandaj, licenca e dorëzuar duhet të vlerësohet në bazë të fushëveprimit të saj dhe të detyrave konkrete të parapara në kontratë, si matjet GPS, hartat topografike dhe kadastrale, si dhe identifikimi i parcelave.

Në thelb, OE-ja nuk kërkon ndryshimin e kriterit të tenderit dhe as zëvendësimin e personelit, por kërkon që licenca ekzistuese e AKK-së të shqyrtohet dhe të vlerësohet në raport me kërkesat e dosjes së tenderit dhe legjislacionin përkatës. Për këtë arsye, kërkon nga OSHP-ja pranimin e licencës dhe heqjen e vendimit për eliminim, ose marrjen e sqarimeve nga institucionet kompetente për të përcaktuar nëse për detyrat konkrete të kontratës kërkohet edhe licencë nga OIRK-ja.

Përgjigje nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues, gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ne dosjen e tenderit, konstaton se në pikën 7 të Fletës së të Dhënave të Tenderit (FDT) është kërkuar qartësisht:

7. 1 (një) Inxhinier Gjeodezie, me diplomë universitare ose Master i Shkencës (MSc), me minimum 3 (tre) vite përvojë pune.

7. Dëshmia: Të dorëzohen CV-ja, licenca A, diploma, referencat e punës dhe kontrata e punës.

Pra **Licenca A** ka qenë qartë e përcaktuar si dëshmi për kërkesën e dosjes së tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ofertës së OE-së ankues, eksperti shqyrtues konstaton se OE nuk e ka dorëzuar **Licenca A** e kërkuar në Dosjen e Tenderit, por licenca e lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK). Edhe pas kërkesës B47 të dt. 26.08.2026 e bërë nga ana e AK në procesin e vlerësimit për sqarimin e tenderit, OE ankues nuk e ka dorëzuar Licencën A, por ka trajtuar aspektet ligjore te licencimit të gjeodetëve nga AKK.

Eksperti shqyrtues thekson se AK ka përcaktuar si dëshmi **Licencën A** dhe jo licencën e lëshuar nga AKK-ja. Rrjedhimisht, operatorët ekonomikë kanë qenë të obliguar që ofertat e tyre ti përgatisin në përputhje me kërkesat e publikuara në Dosjen e Tenderit dhe të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar për përmbushjen e kritereve të përcaktuara.

Në këtë rast, çështja nuk lidhet me vlefshmërinë dhe kompetencën e licencës së lëshuar nga AKK-ja, por me përmbushjen e kërkesës dokumentare të përcaktuar shprehimisht në Dosjen e Tenderit.

Në këtë drejtim, ***neni 59, paragrafi 4, i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se autoriteti kontraktues do ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse ai është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit***. Pra vlerësimi i përgjegjshmërisë së ofertës duhet të bëhet në raport me kërkesat konkrete të publikuara, përfshirë edhe dëshmitë e kërkuara për kualifikimin profesional të stafit. Nëse kërkesa për Licencë A është kërkesë e dosjes së tenderit në pikën përkatëse, dorëzimi i një dokumenti tjetër nuk mund të konsiderohet si përmbushje e kriterit.

Në bazë të dokumenteve të siguruara dhe komunikimit në mes OE ankues dhe AK në proces, duhet të theksohet se OE ankues nuk e ka prezentuar **Licencën A** e cila është kërkuar në dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE-së ankues se licenca e AKK-së duhet të pranohet si dëshmi për përmbushjen e këtij kriteri, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo çështje është dashur të trajtohet gjatë fazës së tenderimit, përmes kërkesës për sqarime lidhur me Dosjen e Tenderit, në përputhje me nenin 53 të LPP-së. Kjo dispozitë u mundëson operatorëve ekonomikë të kërkojnë sqarime për elementet e Dosjes së Tenderit, në mënyrë që kërkesat dhe dëshmitë e nevojshme për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit të kuptohen qartë para përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave.

Nëse OE ankues ka konsideruar se licenca e lëshuar nga AKK-ja duhet të pranohet si alternativë ndaj Licencës A të kërkuar, ai ka pasur mundësi që këtë çështje ta trajtoj në fazën e sqarimit të Dosjes së Tenderit, duke kërkuar nga AK-ja të sqarojë nëse licenca e AKK-së mund ta përmbushë kriterin e përcaktuar. Kjo do të mundësonte trajtimin paraprak të çështjes dhe, nëse do të ishte e nevojshme, ndërmarrjen e veprimeve përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi. Tani gjatë fazës së vlerësimit nuk mund të ndryshohen apo zëvendësohen kërkesat e dosjes së tenderit.

Eksperti shqyrtues vlerëson se në këtë fazë të procesit pranimi i licencës së AKK-së si zëvendësim i Licencës A, mund të rezultojë në zbatim jo të njëtrajtshëm të kritereve dhe në cenim të parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Të gjithë ofertuesit duhet të vlerësohen mbi bazën e të njëjtave kërkesa të publikuara dhe nuk mund të krijohen kushte të ndryshme për një operator ekonomik gjatë fazës së vlerësimit.

Përfundimisht, eksperti shqyrtues konsideron se përmbushja e kriterit duhet të vlerësohet në përputhje me kërkesat e FDT-së, nenin 59, të LPP-së.

Eksperti konsideron se pretendimi ankimor 2 është i pabazuar

Pretendimi ankimor 3 - 8.3 Emërimi i menaxherit për një përbërje tjetër të grupit

OE ankues pretendon se ekziston një mospërputhje në vendimin për emërimin e Agim Lajçit si Menaxher i Kontratës. Sipas tij, në dokumentin e dorëzuar figurojnë ENG IDEA SH.P.K. dhe ARCH EMPIRE L.L.C., ndërsa grupi i rekomanduar për kontratë përbëhet nga ENG IDEA SH.P.K. dhe Lorenco & Co SH.P.K.

OE-ja thekson se ARCH EMPIRE nuk është pjesë e grupit të rekomanduar, ndërsa Lorenco & Co, e cila është anëtare e këtij grupi, nuk figuron në vendimin për emërimin e menaxherit. Për këtë arsye, ai vë në dyshim nëse ekziston dëshmi se Agim Lajçi është emëruar dhe angazhuar rregullisht nga grupi konkret që ka dorëzuar ofertën.

OE kërkon kontrollin e vendimit origjinal, nënshkruesit, marrëveshjes së GOE-së, autorizimeve sipas FDT 11.1 dhe dokumenteve të angazhimit të menaxherit. Nëse këto provojnë objektivisht se emërimi për grupin e saktë ekzistonte më 31.07.2026, OSHP-ja mund të vlerësojë nëse kemi gabim formal të sqarueshëm. OE në këtë rast nuk pretendon se çdo gabim në emërtim sjell automatikisht eliminim. Megjithatë, sipas OE ankues pa këtë provë, një vendim i ri ose zëvendësimi pas afatit i partnerit të shënuar do të rrezikonte krijimin e një angazhimi që nuk është dëshmuar në kohën e kërkuar, në kundërshtim me nenet 59.2 dhe 72.

Nëse angazhimi për grupin ofertues nuk provohet mbi dokumente dhe fakte që ekzistonin para afatit, OE ankues kërkon që pretendimi të aprovohet dhe oferta e rekomanduar të konsiderohet e papërgjegjshme për këtë kërkesë.

Përgjigje në pretendimin 3

Eksperti ka analizuar pretendimin ankimore dhe vlerëson se pretendimi ka të bëjë me atë nëse dokumentet e tenderit dëshmojnë se inxhinieri i hidroteknikës, i propozuar si Menaxher i Kontratës, ishte i angazhuar për grupin konkret të operatorëve ekonomikë (GOE) në afatin e dorëzimit të tenderit pasi që në dokumentin e ofruar nga GOE figuron nje OE tjeter e jo anetari i konzorciumit.

Gjate analizes se kerkeses se dosjes se tenderit dhe deshmive te kerkuara dokumentare eksperi konstaton se Vendimi i autorizimit per menaxherin e kontrates si dokument nuk ka qenë pjese e kerkeses se deshmive dokumentare.

Kërkesa e dosjes:

1.1 (një) Inxhinier i Hidroteknikës, me diplomë universitare ose Master i Shkencës (MSc), i angazhuar si Menaxher i Kontratës nga Operatori Ekonomik, me minimum 5 (pesë) vite përvojë pune.

1. Dëshmia: Të dorëzohen CV-ja, licenca A, diploma, referencat e punës dhe kontrata e punës.

Konform nenit 59 të LPP-së AK do të vlerësoj vetëm në bazë të kërkesave dhe dokumenteve të kërkuara në dosjen e tenderit.

Megjithatë eksperti shqyrtues ka analizuar faktet dhe jep sqarimet se Neni 71, paragrafi 4 i LPP-së dhe neni 26, paragrafi 5 i Rregullores Nr. 001/2022 përcaktojnë se kërkesat për aftësi teknike dhe profesionale zbatohen ndaj GOE-së si tërësi, e jo veçmas ndaj secilit anëtar. Kjo, megjithatë, nuk e përjashton nevojën që dokumentet e tenderit të dëshmojnë se kapaciteti i kërkuar ishte në dispozicion të GOE-së së ofertuesit. LPP dhe Rregullorja nuk përcaktojnë shprehimisht se

vendimi për emërimin e Menaxherit të Kontratës duhet të nënshkruhet nga secili anëtar i GOE-së. Megjithatë, neni 26.1 (c) i Rregullores kërkon që të gjithë anëtarët e grupit ta autorizojnë partnerin udhëheqës të veprojë në emër të grupit. GOE ka dorëzuar marrëveshjen e themelimit të grupit dhe ka specifikuar autorizimet përkatëse dhe ka përcaktuar liderin e grupit si përfaqësues legjitim. Kur marrëveshja GOE e dorëzuar me tenderin e përmban këtë autorizim, vendimi i liderit për emërimin e Menaxherit të Kontratës nuk ka nevojë të nënshkruhet veçmas nga secili anëtar, përveç nëse FDT-ja ka vendosur ndonjë kërkesë specifike shtesë. Prandaj, fakti që autorizimi për menaxherin është lëshuar nga lideri është i mjaftueshëm, pavarësisht që në këtë autorizim figuron edhe nje OE tjetër.

Në rastin konkret, vendimi i datës 30.07.2026, i cili në fushën "Nga" përmend ENG IDEA SH.P.K. dhe ARCH EMPIRE L.L.C., duhet krahasuar me përbërjen e GOE-së ofertues, ENG IDEA SH.P.K. dhe Lorenco & Co SH.P.K. Vetëm fakti që ENG IDEA SH.P.K. është verifikuar në marrëveshjen e GOE-së dhe në autorizimet përkatëse ENG IDEA është autorizuar nga Lorenco & Co të vepron në emër të grupit si lider i grupit, si dhe vendimi i emërimit të menaxherit të kontratës e bën të qartë angazhimin e inxhinierit për kontratën duke specifikuar titullin e procedurës së prokurimit. Po ashtu edhe në listën e stafit të ofruar nga GOE i rekomanduar është e specifikuar qartë detyra e inxhinierit si menaxher i kontratës. Përmendja e ARCH EMPIRE L.L.C., e cila nuk është anëtare e GOE-së, nuk e bën vendimin e pavlefshëm e as nuk e konteston angazhimin e inxhinerit për projektin në fjalë.

Eksperti vlerëson se në bazë të marrëveshjes së GOE-së dhe autorizimit të ENG IDEA-s si partner udhëheqës, konstatohet se ENG IDEA ka pasur të drejtë të veprojë në emër të grupit ENG IDEA SH.P.K. dhe Lorenco & Co SH.P.K. Prandaj, vendimi i emërimit i datës 30.07.2026 e përmban nënshkrimin/vulën e ENG IDEA-s dhe provon angazhimin e menaxherit për projektin konkret, mospërputhja në përmendjen e ARCH EMPIRE L.L.C. nuk ndryshon përmbajtjen materiale të tenderit.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 4 - 8.4 Autorizimi profesional i Almedina Rapucës

OE ankues pretednon se grupi i rekomanduar e ka propozuar Almedina Rapucën me licencë A të OIRK-së nr. N-1218, por nuk ka paraqitur licencë të AKK-së. Sipas OE ankues, disa nga detyrat e përshkruara në Aneksin 1 mund të kërkojnë licencim nga AKK-ja për matje kadastrale ose gjeodezike.

OE ankues nuk ka kundërshtuar vlefshmërinë e licencës së OIRK-së dhe as nuk ka kërkuar që në FDT të shtohet tani një kriter i ri. Ai kërkon që të shqyrtohet nëse detyrat konkrete përfshijnë punë që sipas Ligjit nr. 08/L-237 dhe UA nr. 06/2024 kryhen nga gjeodeti i licencuar prej AKK-së dhe me cfarë autorizimi do të kryhen kët shërbime nga perosneli i propozuar.

Ankuesi gjithashtu pretendon se AK-ja nuk i është përgjigjur plotësisht kësaj çështjeje: vendimi përmend inxhinieren dhe e konsideron kërkesën të përmbushur, por nuk tregon nëse është kontrolluar regjistri i AKK-së dhe nuk shpjegon nëse detyrat e Aneksit 1 kërkojnë licencë të tillë. Sipas OE ankues duhet të verifikohet dhe vlerësohet autorizimi ligjor për punët konkrete dhe se a ka ekzistuar në afatin e ofertimit licenca nga AKK per personin e angazhuar Almedina Rapuca.

Përgjigje në pretendimin 4

Eksperti shqyrtues ka analizuar kerkesen e dosjes se tenderit dhe thekson se Dosja e Tenderit ka kërkuar "***një inxhinier të gjeodezisë, me diplomë universitare ose MSc dhe së paku tri vjet përvojë pune"***. Si dëshmi janë kërkuar "***CV-ja, licenca A, diploma, referencat e punës dhe kontrata e punës"***. Pra kërkesa për Licencën A ka qenë e qartë, ndërsa Licenca nga AKK-ja nuk është përcaktuar si dëshmi për këtë kërkesë.

Nga dokumentet e ofertës rezulton se GOE i rekomanduar në kuadër të kërkesës ka propozuar dy inxhinier të gjeodezisë Almedina Rapucën dhe Luan Abazin. GOE për inxhineren e propozuar Almedina Rapuca ka dorëzuar dokumentet e kërkuara në FDT: **CV-në, licencën A, diplomën, referencat e punës dhe kontratën e punës,** që do të thotë se në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit janë dorëzuar dokumentet. Prandaj, vlerësimi i përmbushjes së kërkesës nr. 7 duhet të bëhet mbi kriteret dhe dëshmitë e publikuara në Dosjen e Tenderit. AK-ja nuk mund të shtojë gjatë vlerësimit një kriter të ri për licencë të AKK-së, nëse një kërkesë e tillë nuk është paraparë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë. Neni 59 i LPP-së kërkon që tenderi të vlerësohet kundrejt kërkesave të publikuara, ndërsa sqarimet nuk mund të përdoren e as të pranohen për të ndryshuar aspektin material të tenderit.

Pretendimi se disa detyra mund të kërkojnë licencim nga AKK-ja duhet dalluar nga kriteri i përzgjedhjes në një procedurë tenderimi. Kjo nuk e dëshmon se GOE nuk e ka përmbushur kërkesën nr. 7, e cila kërkonte decidivisht **licencën A**. Përvec kësaj sipas të dhënave të paraqitura në dokumentet e ofertës, GOE i rekomanduar ka përfshirë edhe një gjeodet tjetër me licencë të AKK-së. Nëse ky gjeodet është pjesë e stafit të propozuar dhe dokumentet e ofertës tregojnë se detyrat që kërkojnë licencim do t'i kryejë ose nënshkruajë ai, që do të thotë se GOE ka paraparë personel të licencuar për ato punë, mirëpo kjo nuk mund të përfshihet si kriter vlerësimi në dosjen e tenderit.

Në bazë të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe dokumenteve të dorëzuara për Almedina Rapucën, kërkesa nr. 7 vlerësohet e përmbushur, pasi janë paraqitur dëshmitë e kërkuara, përfshirë licencën A. Pretendimi për mungesë të licencës së AKK-së nuk mund të shërbejë si bazë për ta shpallur ofertën të papërgjegjshme për këtë kriter, pasi kjo licencë nuk ishte kërkuar në FDT.

Eksperti vlerëson se pretendimi ankimor 4 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 5 - 8.5 Trajtimi i barabartë në sqarime dhe në vlerësimin e ofertave

OE ankues në këtë pretednim ka kërkuar një trajtim të barabartë ku ka evidentuar se në kërkesën për rishqyrtim ka identifikuar kërkesat për sqarim ndaj grupit të rekomanduar të datave 26.08.2026, 02.09.2026 dhe 15.09.2026. Vetë numri i kërkesave nuk përbën shkelje, sikurse fakti që edhe neve na janë kërkuar sqarime nuk provon vetvetiu se vlerësimi ka qenë i barabartë. Vendimtare është përmbajtja e sqarimeve, provat mbi të cilat janë pranuar dhe nëse ato dëshmojnë gjendjen para afatit.

OE ankues ka kërkuar nga eksperti që të krahasojë përgjigjen e OE ankues të datës 31.08.2026 me sqarimet e grupit të rekomanduar lidhur me pretendimet e mësipërme. OE ka deklaruar se për licencën tonë kërkohet vlerësim i arsyetuar i fushëveprimit; për menaxherin kërkohet lidhja e angazhimit me grupin e saktë; për gjeodeten kërkohet verifikimi i autorizimit të nevojshëm. Për të tria duhet zbatuar standardi i njëjtë i provës dhe i ekzistencës së kapacitetit para afatit.

OE ankues ka theksuar se nëse dokumentet e grupit të rekomanduar pranohen duke plotësuar paqartësi, ndërsa dokumentit tonë ekzistues i mohohet shqyrtimi përmbajtësor, pa dallim objektiv të arsyetuar, cenohen nenet 7 dhe 72 të LPP-së dhe neni 38 i Rregullores.

Qëndrimi i OE ankues është se GOE i tyre i plotëson kërkesat e DT-së. Sipas OE ankues formulari B58 nuk identifikon mangësi tjetër përveç licencës, por kjo nuk e zëvendëson kontrollin e dokumentacionit të ofertës. Pas heqjes së shkakut të eliminimit dhe konfirmimit të përgjegjshmërisë, AK-ja duhet ta përfshijë ofertën tonë në krahasimin sipas kriterit të çmimit më të ulët të nenit 60.1.1 dhe FDT 30.1. Diferenca 184.530,00 € − 177.750,00 € = 6.780,00 € është kursim potencial i fondeve publike, në lidhje me nenet 1 dhe 6 të LPP-së.

OE ankues në këtë pretednim ka dekalaruar se qëndrojnë prapa pjesës së vendimit të AK-së me të cilën ofertuesit e tjerë janë shpallur të papërgjegjshëm dhe nuk kërkojmë ndryshimin e atyre eliminimeve me këtë ankesë, njësoj siç kanë deklaruar edhe në kërkesën për rishqyrtim të datës 28.09.2026.

Përgjigje në pretendimin 5

Eksperti shqyrtues ka analizuar komunikimet ndërmjet AK-së dhe operatorëve ekonomikë ofertues, përfshirë kërkesat për sqarim dhe përgjigjet e dhëna. Nga shqyrtimi i tyre vlerësohet se AK i ka trajtuar sqarimet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe me dispozitat përkatëse të legjislacionit të prokurimit publik. Numri i kërkesave për sqarim, në vetvete, nuk dëshmon trajtim të pabarabartë. Vlerësimi mbështetet në përmbajtjen e kërkesave, përgjigjeve dhe dokumenteve përkatëse.

Sa i përket përgjigjes së OE-së ankues të datës 31.08.2026, eksperti vëren se në të janë paraqitur argumente ligjore lidhur me licencës të AKK-së, ndonëse Dosja e Tenderit për kërkesën përkatëse përcaktonte shprehimisht dorëzimin e **licencës A**. OE ankues ka dorëzuar licencën e AKK-së dhe ka dhënë sqarime shtesë për fushëveprimin e saj. Megjithatë, këto sqarime nuk mund ta zëvendësojnë ose ta ndryshojnë kërkesën e publikuar në Dosjen e Tenderit, përmbushja e kërkesës duhet të vlerësohet sipas dëshmive të kërkuara, përkatësisht licencës A, dhe jo sipas një kriteri tjetër të arsyetuar gjatë fazës së vlerësimit nga OE ankues.

Për pretendimin se AK-ja nuk ka zbatuar të njëjtin standard ndaj operatorit të rekomanduar, eksperti vlerëson se komunikimet e shqyrtuara nuk e mbështesin këtë pretendim. Sqarimet e secilit operator janë trajtuar në raport me kërkesat përkatëse të Dosjes së Tenderit dhe dokumentet e paraqitura në ofertë. Për rrjedhojë, pretendimi për trajtim të pabarabartë vlerësohet i pabazuar.

Eksperti vlerëson se pretendimi ankimor 5 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 6 - 8.6 Mangësitë e arsyetimit në vendimin e datës 30.09.2026

OE ankues në këtë pretednim e ka cilësuar përgjigjen e AK në vendimin e dt.30.09.2026 si të pamjaftueshme duke mos e lidhur përfundimin me provat dhe argumentet vendimtare të secilës çështje. Sipas OE nakues, AK ka identifikuar tri çështjet kryesore në faqen 2: licencën e gjeodetit, emërimin e menaxherit dhe autorizimin e Almedina Rapucës.

Në faqen 2 të vendimit, nga kërkesa për rishqyrtim janë riprodhuar vetëm paragrafi hyrës dhe titujt e pikave 7.2 dhe 7.3. Asnjë nga argumentet juridike e faktike të kërkesës, si licenca nr. 115

dhe vendndodhja e saj në ofertë, Ligji nr. 08/L-237, UA nr. 06/2024, shkresa e AKK-së dhe detyrat e Aneksit 1, nuk është përmendur apo trajtuar në arsyetim.

OE ankues thekson se: Për ofertën tonë, AK-ja përsërit se mungon Licenca A e kërkuar në DT dhe se dokumenti nuk është paraqitur as në rishqyrtim. Duke deklaruar se në pretendimin e tyre kanë kërkuar vlerësimin e licencës së AKK-së nr. 115 si autorizim për punët konkrete. Vendimi i AK nuk trajton vendndodhjen e saj në ofertë, vlefshmërinë, dispozitat sektoriale, detyrat e Aneksit 1 apo shkresën e AKK-së.

Ndërsa për grupin e rekomanduar, AK-ja shprehet se "i ka faluar besimin të gjeturave të komisionit vlerësues" (vendimi, faqja 2). Sipas OE ankues mbështetja në punën e komisionit nuk e liron autoritetin nga detyrimi për t'iu përgjigjur mospërputhjeve konkrete të ngritura në rishqyrtim. Vendimi nuk shpjegon pse identifikimi i një partneri tjetër në emërimin e menaxherit nuk ndikon në provën e angazhimit, as me cilin dokument ose verifikim është zgjidhur çështja e autorizimit sektorial të gjeodetes.

Po ashtu OE ankues ka dhene bazën ligjore për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësit e AK.

Kërkesa i drejtohet OSHP-së dhe ekspertit shqyrtues të administrojnë dokumentet, t'i analizojnë pretendimet veçmas dhe të japin përfundim meritordhe të japin udhëzimet konkrete të rivlerësimit.

Përgjigje në pretendimin 6

Duke pasur parasysh deklarimet e OE-së ankues në këtë pretendim, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ndërlidhet me përgjigjen e AK-së ndaj çështjeve të trajtuara në kërkesën për rishqyrtim. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dosjes së tenderit, kërkesës për rishqyrtim, përgjigjes së dhënë nga AK në kërkesën për rishqyrtim, komunkimit të bërë ndërmjet AK dhe OE-ve ofertues, eksperti vlerëson se AK i ka shqyrtuar kërkesat dhe sqarimet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat përkatëse ligjore.

Eksperti vlerëson se pretendimi ankimor 6 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 7 - 8.7 Administrimi i provave dhe kërkesa për vendim

OE ankues ne kete pike nuk ka ndonjë pretendim të veçantë, por ka kërkuar nga eksperti shqyrtues, në kuadër të neneve 113 dhe 114 të LPP-së, të administrojë dosjen elektronike të plotë të aktivitetit dhe të raportojë veçmas për secilin pretendim.

Në veçanti kërkohen këto verifikime:

1. Të kontrollohen oferta fillestare e GOE-së sonë, faqja 24 e dosjes së gjeodetit, përgjigjja e datës 31.08.2026 dhe vlefshmëria e licencës nr. 115 në afatin e ofertimit.

2. Të krahasohen detyrat e Aneksit 1 dhe kërkesa nr. 7 me fushëveprimin e licencimit nga AKK-ja dhe OIRK-ja; sipas nevojës të kërkohen sqarime zyrtare për bazën konkrete ligjore.

3. Të kontrollohen vendimi i Agim Lajçit, marrëveshja e grupit të rekomanduar, autorizimi i liderit dhe provat që lidhin angazhimin me ENG IDEA & Lorenco & Co para 31.07.2026.

4. Të verifikohet pranë AKK-së gjendja historike e autorizimit të Almedina Rapucës dhe të sqarohet nevoja e këtij autorizimi për detyrat konkrete të propozuara.

5. Të krahasohen sqarimet B47 të të dy grupeve, raporti i vlerësimit, provat e ngarkimit dhe baza mbi të cilën komisioni ka pranuar ose refuzuar dokumentet e kundërshtuara.

Përgjigje në pretendimin 7

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në legjislacionin përkatës ka shqyrtuar tërë dokumentacionin e lëndës dhe të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë, ku për secilin pretendim ka dhënë përgjigje konkrete, duke u mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore të LPP-së. Çështjet që nuk janë përcaktuar si kërkesa në Dosjen e Tenderit dhe që nuk paraqesin aspekt material për vlerësimin e ofertave nuk janë konsideruar të domosdoshme për trajtim ose verifikim të mëtejmë. Çështjet që nuk ajnë pjesë e kritereve të dosjes së tednerit dhe rregullohen me legjislacion të veçantë që lidhen me kryerjen e detyrave gjatë realizimit të kontratës trajtohen në përputhje me atë legjislacion gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës.

REKOMANDIMI EKSPERTIT SHQYRTUES:

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 12/10/2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0782/2026, ndërsa me datë 23/10/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0782 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të pranohet si pjeserisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- - Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të

pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vren se Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës publike furnizim me material hixhenik. Vlera e parashikuar 200,000€. Kriteret e Dhënies së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,27,54,59,60,66,69,71,72 dhe 108/A të LPP-së, nenit 38,40 dhe 63 të Rregullores se Prokurimit Publik. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër vendimit te AK me te cilin ka rekomanduar per dhenje kontrate operatorin ekonomik, ndërsa ankuesin e ka eliminuar per mosplotësim te kritereve te DT. Operatori ekonomik i ankimon arsyet e eleminimit te tij per mosplotësim kërkesave te dosje se tenderit, por njëkohësisht paraqet pretendime ankimore ndaj operatorit ekonomik te rekomanduar per mosplotësim te kritereve te dosjes se tenderit dhe kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e vendimit të AK-se dhe kthimin e aktivitetit në rivlerësim.

Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe kërkesave te dosjes se tenderit, duke i vlerësuar pretendimit ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe ka rekomanduar te mbetet ne fuqi vendimi i autoritetit kontraktues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në ketë rast. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore konstaton se ankesa është pjesërisht e bazuar dhe mbet ne fuqi vendimi autoritetit kontraktues.

Lidhur me pretendimin ankimor te ankuesit se ka ofertuar me qmim me te lire se sa operatori ekonomik i rekomnaduar, Paneli konstaton se autoriteti kontraktues ka vepruar sipas nenit 60 Kriteret e Dhenjes, duke rekomanduar per kontrate OE të vlersuar si i pergjegjeshem nga autoriteti kontraktues- i ka plotësuar te gjitha kriteret Dosjes tenderit sipas neneit 60 paragrafi1., per tu shpërblyer me kontrate, i cili përcakton;

”Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës;1,Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;, andaj dhe nuk mjafton vetem qmimi por duhet te jete dhe I pergjegjeshme, andaj dhe autoriteti kontraktues ka vepruar sipas ligjit ndersa pretendimi ankomor eshte pjeserisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te ankuesit se autoriteti e ka eleminuar padrejtësisht lidhur me mospranimin e licenca profesionale e gjeodetit, kërkesa e FDT-në, pikat 9.1 dhe 9.2, kërkesa nr. 7, Paneli vren se OE ankues ne ofereten e tij nuk e ka prezentuar Licencën A e cila është kërkuar në dosjen e tenderit. Ankuesi fillimisht ka mundur qe ti ankimojne kriteret e Dosjes se tenderit lidhur me ket qeshtje , apo përmes kërkesës peer sqarime në përputhje me nenin 53 të LPP-së me autoritetin kontraktues ta definojnë qeshtjen e pranushmerise se licencës se ofruar, andaj dhe autoriteti kontraktues ka vepruar sipas kerkesave te DT, ndersa pretendimi ankomor eshte i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor te ankuesit, se GOE i rekomanduar nuk e ka Emërimin e menaxherit për një përbërje tjetër të grupit, Paneli vren se ne ofereten e tyre në bazë të marrëveshjes së GOE-së dhe autorizimit të ENG IDEA-s si partner udhëheqës, konstatohet se ENG IDEA ka pasur të drejtë të veprojë

në emër të grupit ENG IDEA SH.P.K. dhe Lorenco & Co SH.P.K. dhe vendimi i emërimit i datës 30.07.2026 e përmban nënshkrimin/vulën e ENG IDEA-s dhe provon angazhimin e menaxherit për projektin konkret, mospërputhja në përmendjen e ARCH EMPIRE L.L.C. nuk ndryshon përmbajtjen materiale të tenderit. Ligji prokurimit dhe Rregullorja nuk përcaktojnë se vendimi për emërimin e Menaxherit të Kontratës duhet të nënshkruhet nga secili anëtar i GOE-së. Megjithatë, neni 26.1 (c) i Rregullores kërkon që të gjithë anëtarët e grupit ta autorizojnë partnerin udhëheqës të veprojë në emër të grupit. GOE ka dorëzuar marrëveshjen e themelimit të grupit dhe ka specifikuar autorizimet përkatëse dhe ka përcaktuar liderin e grupit si përfaqësues legjitim. Kur marrëveshja GOE e dorëzuar me tenderin e përmban këtë autorizim, vendimi i liderit për emërimin e Menaxherit të Kontratës nuk ka nevojë të nënshkruhet veçmas nga secili anëtar, përveç nëse FDT-ja ka vendosur ndonjë kërkesë specifike shtesë andaj dhe nënshkrimi nga lideri përkon me autorizimet e tija,me qka vlerësohet se i përgjigjet kërkesës së DT, andaj dhe ky pretendim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor per Trajtim pa barabartë në sqarime dhe në vlerësimin e ofertave ne e raport me GOE te rekomanduar, Paneli vren se ankuesi nuk ka paraqitur konkretisht ndonjë fakt apo prove te trajtimit te pabarabart nga autoriteti kontraktues, por nga deshmit e rastit ne sistem e-prokurimi vrehet se te gjithë operatoret ekonomik kane paraqitur kerkesa per sqarime dhe i janë dhen përgjigje nga autoriteti, por nuk do te mund te thuhet trajtim i parabart nëse nje OE ka paraqitur me shume kekresa sqarimi se sa ndonjë operator tjetër ekonomik, andaj vrehet se autoritet ka aplikuar standarde te njeta ndaj operatorve ekonomik, prandaj dhe pretendimi ankimor eshte i pabazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor se autoriteti kontraktues ka Mangësitë e arsyetimit në vendimin e datës 30.09.2026 Paneli vren pretendimi ndërlidhet me përgjigjen e AK-së ndaj çështjeve të trajtuara në kërkesën për rishqyrtim dhe nga dokumentet të dosjes së tenderit, përgjigjes së dhënë nga AK në kërkesën për rishqyrtim, vrehet se AK i ka shqyrtuar kërkesat dhe sqarimet në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat përkatëse ligjore. Por paneli thekson se per mangsit te cilat pretendon se i ka arsyetimi i vendimit te AK-se, ankuesi ka mund qe me prova dhe faktim ti paraqesë te gjitha mangsit ne organin administrative per ankese sipas këshillës juridike te aktit te ankimuar, andaj dhe pretendimi ankimor eshte i pabazuar.

Paneli shqyrtues pa u lëshuar me tej në secilin pretendim ankmor, paneli i mbështet konstatimet dhe vlersimet e dhëna ndaj pretendimemeve ankimore edhe nga eksperti shqyrtues në Raportin nr,2026/0782, te dates 23.10.2026, dhe paneli vlerson se pretendimet ankimore te vlersuara te OE ankues, jane të pamjaftushme per ndryshimin e vendimit te autoritetit kontraktuese.

Paneli rrjedhimisht lidhur me aktivitetin e prokurimit: “184 - Studimi i fizibilitetit per furnizimin me uje permes puseve dhe rezervuareve ne fshatrat e Gollakut.” me nr. të prokurimit: "616-26-5518-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)S Komuna e Prishtinës dhe ka vendosur që ankesa të aprovohet si pjesërisht e bazuar e të N.N.SH. “Vizion Project "dhe Mbetet në fuqi B58 “Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues”dt.21.09.2026, rekomandimin per kontrate operatorit ekonomik ENG IDEA SH.P.K. & Lorenco & Co SH.P.K. ,lidhur me aktivitetin e prokurimit te larteshenuar, dhe se autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-se.

Paneli sqaron se po ashtu kërkesat e autoritetit kontraktues janë të paracaktuara në dosjen e tenderit dhe si të tilla është përgjegjësi publike për të gjithë ofertuesit eventual, duhen të udhëhiqen nga parimi i kujdesit në plotësimin e kushteve të formale në kohë dhe brenda afatit të përcaktuar, kurse kthimi i një aktiviteti të prokurimit në vijim të provave jo kontestuese nuk ofron bazë ligjore për ri-vlerësimin eventual të tij dhe nuk është në harmoni me nenin 1 dhe nenit 7 të LPP. Në fakt synimi i aktiviteteve të prokurimit i referohet dhe nenit 104 paragrafi 4 i LPP-së, Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, (ii) të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit si të pjesërishëm të ankeses të N.N.SH. “Vizion Project "vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- OE - **N.N.SH. " Vizion Project "**
- Arkivës së OSHP-së: